




Informator për Subvencionet në Bujqësi

A large, faint, light green graphic of a stylized human figure is centered on the page. The figure has a circular head and a rounded, open-bottom body, resembling a person with arms slightly out to the sides. The text is overlaid on the torso of this figure.

Informator për Subvencionet në Bujqësi

Informator për Subvencionet në Bujqësi

Ky informator ka për qëllim informimin me kohë të qytetarëve, dhe grupeve tjera të interesit (OJQ, organizata fermere, fermerë, etj) për subvencionet që japin komunat Pejë, Deçan, Rahovec, Klinë dhe Istog. Këto subvencione komunat i japin kryesisht përmes Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidro-ekonomi, ndonjëherë edhe përmes Zyrës së kryetarit të komunës.

Qëllimi i këtyre subvencioneve është mbështetja e zhvillimit ekonomik në vend, përmes zhvillimit të programeve apo projekteve në fushën e bujqësisë, blegtorisë si dhe të sektorëve të tjerë, varësisht prej specifikave që përcaktohen nga vetë komunat.

Subvencionet kryesisht shpërndahen nga Drejtoritë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidro-ekonomi, ku në web faqen e secilës komunë publikohen njoftimet dhe kriteret për subvencione, qoftë nga kjo drejtori por edhe nga drejtoritë tjera si dhe në disa raste edhe nga kabineti i kryetarit të komunës.

Andaj Syri i Vizionit për të lehtësuar qasjen dhe lehtësime në informimin e qytetarëve për shërbimet që ofrohen në kuadër të institucioneve, gjegjësisht të këtyre drejtorive, ka bërë të mundur realizimin e këtij informatori me informata të plota për të pasur qasje sa më të mirë dhe të drejtë me qëllim të plotësimit të kërkesave të qytetarëve. Ky informator është realizuar në kuadër të projektit Qytetaria Aktive në Kosovë, që implementohen nga OJQ Syri i Vizionit dhe mbështetet nga Olof Palme International Center si dhe SIDA.

Për detaje të përgjithshme këtu mund të gjeni me kohë informatat e duhura, njoftimet dhe konkurset që shpallen nga institucionet lokale lidhur me subvencionet:

Komuna e Pejës

Komuna e Pejës:

<http://kk.rks-gov.net/peje/>

Zyra e informimit:

<https://kk.rks-gov.net/peje/Kryetari/Zyra-e-Informimit.aspx>

E-mail: zip-peje@hotmail.com

arianit.demaj@rks-gov.net

granit.thaqi@rks-gov.net | ariana.lukaj@rks-gov.net

Tel: +386 (0) 49 125 089 | +386 (0) 49 300 058 | +386 (0) 49 766 739

Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit: <http://kk.rks-gov.net/decan/>

Zyra e informimit:

E-mail: yllartathaqi@gmail.com

Tel: +377 (0) 45 120 715

Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit: <http://kk.rks-gov.net/rahovec/>

Zyra e informimit: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/Municipality/Zyret/Zyra-per-Informim.aspx>

E-mail: haziz.krasniqi@rks-gov.net

Tel: +377 (0) 44 18 31 77

Komuna e Klinës

Komuna e Klinës: <http://kk.rks-gov.net/kline/>

Zyra e informimit:

E-mail: samije.gjergjaj@ks-gov.net

Tel: (038) 200 43 716

Komuna e Istog

Komuna e Istog: <http://kk.rks-gov.net/istog/>

Zyra e informimit: <https://kk.rks-gov.net/istog/Municipality/President/Zyra-per-Informim.aspx>

E-mail: jeta.balaj@rks-gov.net

Tel: (038) 20 043 881

Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorive për bujqësi, pylltari dhe Hidro-ekonomi nëpër komuna?!

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi Pejë

Kjo drejtori ka për detyrë:

1. Krijimin e kushteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore (tokës, pyjeve, kullosave dhe ujit) modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve për të krijuar një mjedis favorizues për rritjen e mirëqenies së qytetarëve në viset rurale të Komunës së Pejës.

2. Zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe punës përmes:

- a. Investimeve kapitale (Infrastruktura e ujitjes),*
- b. Ofrimit të këshillave për fermerë mbi teknologjitë e reja në prodhimtarin bujqësor,*
- c. Subvencionimit në sektorin e gjedhtarisë dhe bletarisë,*
- d. Hulumtimit të burimeve financiare për sektorin e bujqësisë,*
- e. Mbështetjes për iniciativat e fermerëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë të prodhimeve bujqësore.*

3. Bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, biznesin lokal dhe të jashtëm, drejt realizimit të projekteve zhvillimore komunale për një ambient më të mirë të zhvillimit ekonomik-bujqësor.

Kontakti:

Web: <http://kk.rks-gov.net/peje/Departments/Local-Infrastructure.aspx>

E-mail: mehdi.mulaj@rks-gov.net

Tel: +386 (0) 49 436 000

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi Deçan

Në kuadër të kësaj drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

- Sektori për bujqësi,
- Sektori për pylltari,
- Sektori për menaxhim me ujëra për ujitje.

Drejtoria kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, si vijon:

1. Ndërmerr masa të planifikimit dhe masa tjera që ndikojnë në përparimin e bujqësisë,
2. Kujdeset të sigurojë që toka bujqësore të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore,
3. Me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Komunës, kujdeset të përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore,
4. Kujdeset që toka bujqësore e cila është shfrytëzuar për destinime tjera e cila nuk ka karakter të përhershëm, t'i kthehet destinimit të parë, përkatësisht të aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projekteve për rikultivim,
5. Ndërmerr masa të planifikimit dhe masa për mbrojtjen dhe ruajtjen e fondit të pyjeve,
6. Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.

Kontakti:

Web: <http://kk.rks-gov.net/decan/Municipality/Departments/Property.aspx>

E-mail: nasim.haradinaj@rks-gov.net

Tel: +377 (0) 45 120 750

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi Istog

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi organizohet në këta dy sektorë: Sektori i Bujqësisë, Buxhetit dhe Hidroekonomisë dhe Sektori për Pylltari.

- Sektori i i Bujqësisë,Buxhetit dhe Hidroekonomisë ka këto kompetenca dhe përgjegjësi: Realizimi i planifikimeve buxhetore si dhe koordinimi i procesit të kërkesave për shpenzime përkatëse buxhetore në nivel të Drejtorisë; Përcjellja e realizimit të planeve të punës së stafit të sektorit të bujqësisë dhe hidroekonomisë; Shqyrtimi i kërkesave të palëve nga lëmi i bujqësisë dhe hidroekonomisë; Kontrollimi i ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore; Përcjellja e realizimit të projekteve në nivel të drejtoratit; Hartimi i planeve për mbjellje pranverore dhe vjeshtore; Ofrimi i trajnimeve nga lëmi i bujqësisë dhe hidroekonomisë; Dhënia e këshillave nga lëmi i bujqësisë dhe hidroekonomisë.

Në këtë sektor përfshihen (funksionojnë) këto pozita: një udhëheqës dhe një zyrtar sektori dhe zyrtari i zhvillimit rural dhe Shërbimeve Këshillimore.

- Sektori i Pylltarisë ka këto kompetencat dhe përgjegjësi: Zbatimi i planit të prerjeve sipas ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi; Dhënia e lejeve për prerje në pyje private; Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe zjarret; Përpunimi i dekadave mujore dhe vjetore; Përgatitja e të dhënave për planet e prerjeve; Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura; Kontrollimi i punëve me kontrate dhe tenderëve; Mbrojtja e pyjeve nga sëmundjet; Mbrojtja e tokave pyjore.

Në këtë sektor funksionojnë këto pozita: Udhëheqësi i Sektorit të Pylltarisë, përgjegjësit e njësive menaxhuese dhe pylltarët e terreneve

Kontakti:

Web: <http://kk.rks-gov.net/istog/Municipality/Departments/Bujqesia.aspx>

E-mail: Januz.kabashi@rks-gov.net

Tel: (038)20043802

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi Klinë

Kjo drejtori në angazhimin e saj realizon këto përgjegjësi:

1. Vendime nga lëmi i bujqësisë në pajtim me ligjet dhe aktet ligjore si dhe angazhohet në dhënien e vlerësimeve profesionale,
2. Harton raporte dhe programe të punës,
3. Planifikon buxhetin e drejtorisë dhe kujdeset për menaxhimin optimal të tij,
4. Koordinon punën dhe bashkëvepron me OJQ-të, kooperativat bujqësore që përkrahin aktivitetin bujqësor,
5. Ofron trajnime përkatëse në lëmin e bujqësisë,
6. Ofron këshilla profesionale fermerëve që merren me bujqësi,
7. Kujdeset rreth ngritjes dhe përmirësimit të sasisë dhe cilësisë së prodhimtarisë bujqësore,
8. Përcjellë studimin e gjendjes së përgjithshme në bujqësi dhe propozon masa për rivitalizimin, konsolidimin dhe transformimin e bujqësisë,
9. Në rast të fatkeqësive natyrore përcakton dëmet e shkaktuara në bujqësi nga persona fizikë dhe juridikë,
10. Përcjell dhe përpunon në mënyrë të vazhdueshme statistikën dhe politikën bujqësore të komunës,
11. Ndhmon në themelimin e shoqatave të fermerëve me qëllim të rritjes së mjeteve të jetesës nëpërmjet bujqësisë.

Kontakti:

Web: <http://kk.rks-gov.net/kline/Municipality/Departments/Property.aspx>

E-mail: enver.marmullaku@rks-gov.net

Tel: (038) 20 043 734

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi Rahovec

Në kuadër të kësaj Drejtorie janë të themeluar këta sektorë: Sektori për bujqësi dhe pylltari dhe Sektori për zhvillim rural. Drejtoria kryen punët dhe ushtron përgjegjësitë si vijon:

1. Masat e planifikimit dhe masa tjera për përparimin e bujqësisë.
2. Siguron që tokat bujqësore të shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore.
3. Me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomike të Komunës, kujdeset të përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore.
4. Kujdeset që toka bujqësore e cila është shfrytëzuar për destinime tjera e cila nuk ka karakter të përhershëm t'i kthehet destinimit të parë, të aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projekteve për rikultivim.
5. Ndërmerr masa të planifikimit dhe masat për ruajtjen e Fondit të pyjeve.
6. Koordinon punën dhe bashkëvepron me OJQ që përkrahin bujqësinë.
7. Ofron trajnime në lëmin e bujqësisë.
8. Monitoron ndihma veterinare dhe përkujdeset për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve shtëpiake.
9. Mbron resurset natyrore: pyjet, rërën dhe thyerjen e gurëve nga kompetenca komunale.
10. Mbron resurset pyjore dhe kujdeset për mbrojtjen e bimëve.
11. Punë tjera nga kompetenca e Komunës nga lëmi i bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Kontakti:

Web: <http://kk.rks-gov.net/rahovec/Municipality/Departments/Bujqesi-dhe-Zhvillim-Rural.aspx>

E-mail: feim.fetoshi@rks-gov.net

Tel: +377 (0) 44 112 528



Syri i Vizionit

**OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER**



SWEDEN